



VENDIM

Nr.127 Datë. 01.12.2014

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LIÇENSIMIT TË SHOQËRISË
“FUTURE ENERGY AL ”SH.P.K. NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT
TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, gërma “a”; 9; 13 pika 1 gërma “ç”; 45 pikat 3 dhe 4 dhe 48, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “f”; 5 pika 1 gërma “f” 8; 10, pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108 datë 09.09.2008, nenit 18, pika 1, gërma “a”, të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve, Nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 01.12.2014, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “FUTURE ENERGY AL ” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi liçensimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “ FUTURE ENERGY AL ” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikura nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë / të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

Për Dokumentacionin e Përgjithshëm

- Neni 9, pika 1

Formati i aplikimit : është plotësuar në mënyrë korrekte

- Neni 9, pika 2

Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor është i plotësuar pjesërisht.(Mungon, Vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata që personi nuk është i përfshirë në një proçes penal të filluar nga organet e drejtësisë.)

- Neni 9, pika 3

Dokumentacioni financiar dhe fiskal është i plotësuar pjesërisht.
(Mungon vërtetimi për shlyerjen e tatim-taksave.)

- Neni 9, pika 4/9, gërma a,b dhe c janë paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.

Për dokumentacionet e munguara, do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/të Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë **“FUTURE ENERGY AL ” sh.p.k.**, për licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGIJISË
Bordi i Komisionerëve



Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

VENDIMIN

Nr.127 Datë. 01.12.2014

**PËR
FILLIMIN E PROÇEDURAVE TË LICENSIMIT TË SHOQËRISË
“FUTURE ENERGY AL ”SH.P.K. NË AKTIVITETIN E
FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundra
Petrit Ahmeti	_____	_____
Adriatik Bego	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Maksim Shuli	_____	_____